- Obligimin e paraqitësit të deklaratës, gjegjësisht ofertës që me fletëparaqitje, gjegjësisht ofertën dërgon dëshminë se janë kryer të gjitha shpenzimet e shfrytëzimit të së patundshmes e cila ofrohet (energji elektrike e harxhuar, komunalit, tatimi në pronë etj.),
- Kriteret për zgjedhjen e ofruesit më të mirë,
- Përmbajtja e deklaratës, gjegjësisht ofertës dhe dokumenteve që është e nevojshme të dërgohet me fletëparaqitje, gjegjësisht ofertën në pajtim me këtë Vendim,
- Adresën për dërgesën e fletëparaqitjes gjegjësisht ofertën,
- Afatin për paraqitjen e fletëparaqitjes gjegjësisht ofertës,
- Vendin dhe kohën e mbajtjes së ankandit publik, gjegjësisht hapjes së ofertave,
- Njoftimin që paraqitësit pas afatit dhe fletëparaqitjet jo të plotësuara gjegjësisht ofertat nuk do të mund të marrin pjesë në procedurën e ankandit publik gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim gjegjësisht të njëjtat do të refuzohen.

Fletëparaqitja gjegjësisht oferta dërgohet në zarf të mbyllur me shënimin e dukshëm në cilën shpallje mbështetet dhe kush është paraqitësi i fletëparaqitjes gjegjësisht ofertës.

Fletëparaqitja gjegjësisht oferta duhet të përmbajë:

1. Për personin juridik- emërtimi, selia dhe numri i telefonit dhe duhet të nënshkruhet nga ana e personit të autorizuar, ekstrakti nga regjistri ekonomik i subjekteve të organeve kompetente dhe vërtetimi mbi numrin identifikues tatimor,
2. Për personin fizik emrin dhe mbiemrin, adresën, numrin e lejes së njoftimit, numrin

amë dhe numrin e telefonit dhe duhet të jetë i nënshkruar,

3. Për ndërmarrësit ekstrakt nga regjistri i organit kompetent dhe vërtetimi i numrit identifikues tatimor.

Në rast se paraqitësi i fletëparaqitjes, gjegjësisht ofertës përfaqëson përfaqësuesin e autorizuar, autorizimin për përfaqësim duhet të jetë e vërtetuar në mënyrë speciale dhe gjygjësore.

Fletëparaqitja, gjegjësisht oferta është jo e plotë nëse nuk përmban krejt çka është e paraparë, nëse nuk janë ofruar të gjitha dokumentet si është e paraparë, gjegjësisht nëse nuk përmban të gjitha shënimet e parapara me shpallje ose shënimet janë të dhëna në kundërshtim me shpalljen.

Neni 14

Procedurën e marrjes së patundshmërisë në pronë publike të komunës Preshevë e zbaton Komisioni nga neni 12 i këtij Vendimi, e cila gjatë procedurës udhëheq procesverbalin edhe pas procedurës kontestuese vërteton propozimin për zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm që i dërgohet Këshillit komunal të komunës Preshevë.

Kushtet për zbatimin e procedurës së ankandit publik, gjegjësisht shqyrtimin e ofertave me shkrim janë të plotësuara nëse arrin më së paku një me kohë dhe fletëparaqitje e plotë, gjegjësisht oferta.

Nëse paraqitësi i fletëparaqitjes me kohë dhe në tërësi, gjegjësisht ofertat nuk i qasen ankandit publik, gjegjësisht hapjes së ofertave me shkrim do të nënkuptohet ka hequr dorë nga fletëparaqitja gjegjësisht oferta.

Paraqitësit jo në kohë, gjegjësisht jo të plota nuk mund të marrin pjesë në procedurën e ankandit publik, ndërsa të paplotësuara, gjegjësisht fletëparaqitjet jo me kohë, gjegjësisht ofertat anulohen.

Propozimi i vendimit mbi zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm pas zbatimit të procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim e sjell Këshilli komunal i komunës Preshevë, në bazë të propozimit të arsyetuar të Komisionit e cila i dërgohet kryetarit të komunës Preshevë.

Aktvendimin mbi zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm, pas zbatimit të procedurës së ankandit publik ose grumbullimit të ofertave me shkrim për marrjen e patundshmërisë në pronë publike e sjell kryetari i Komunës Preshevë.

Aktvendimi i kryetarit të komunës Preshevë është përfundimtarë.

Personi i autorizuar për nënshkrimin e kontratës mbi marrjen e patundshmërisë në pronë publike është kryetari i komunës Preshevë.

3.2. Procedura te tjetërsimi i patundshmërisë nga prona publike

Neni 15

Vendimin mbi iniciimin e procedurës së tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike e sjell Kuvendi në propozim të Këshillit.

Vendimi mbi iniciimin e procedurës përmban:

- Llojin e procedurës për tjetërsimin e patundshmërisë (ankandi publik ose grumbullimi i ofertave),
- Karakteristikat e patundshmërisë e cila tjetërsohet nga prona publike,
- Çmimi fillestar i shitblerjes,
- Lartësinë e hapit të licitimit,
- Lartësinë dhe mënyrën e dhënies së depozitit,
- Caktimi i personave që kanë të drejtë pjesëmarrje,
- Kriteret që do të zbatohen te vlerësimi i ofertës dhe
- Datat ku do të zbatohen fazat e veçanta të procedurës,

Vendimi mbi iniciimin e procedurës së tjetërsimit mund të përmbajë edhe elemente tjera të parapara me Ligj me Urdhëresë dhe me këtë Vendim.

Pas nxjerrjes së Vendimit mbi iniciimin e procedurës së tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike në bazë të Ligjit, Këshilli komunal i komunës Preshevë formon komisionin për zbatimin e procedurës së tjetërsimit të patundshmërisë, e cila shpallë shpalljen mbi zbatimin e procedurës së ankandit publik ose grumbullimit të ofertave me shkrim për tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike, e cila duhet të jetë e shpallur në fletën ditore e cila distribuohet në tërë territorin e Republikës së Serbisë.

Neni 16

Shpallja nga neni 15 i këtij Vendimi gjithsesi përmban:

- Emërtimin e organit dhe shfrytëzuesit e patundshmërisë e cila tjetërsohet nga prona publike të cilën e shpallë në shpallje (emërtimi i shitësit),
- Shënimet më të afërta mbi mënyrën e tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike (ankandi publik ose grumbullimi i ofertave me shkrim),
- Përshkrimi i patundshmërisë e cila tjetërsohet nga prona publike,
- Çmimin fillestar me të cilën patundshmëria tjetërsohet nga prona publike,
- Afatet e pagesës,
- Kriteret për zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm,
- Lartësinë dhe mënyrën e paraqitjes së depozitit,
- Afatin për kthimin e depozitit pjesëmarrësve të cilët nuk kanë pasur sukses në ankandin publik, gjegjësisht në procedurën e grumbullimit të ofertave me shkrim,

- Përmbajtja e obligueshme e fletëparaqitjes, gjegjësisht ofertës dhe dokumenteve që janë të nevojshme për ti dërguar me fletëparaqitje, gjegjësisht ofertë, në pajtim me këtë Vendim,
- Adresën për dërgesën e fletëparaqitjes, gjegjësisht ofertës,
- Vendin dhe kohën e qasjes në dokumentacion (aktet mbi pronësinë dhe shpenzimet e shlyera të shfrytëzimit të së patundshmes) lidhur me patundshmërinë e cila tjetërsohet nga prona publike,
- Afatin për paraqitjen e kërkesës, gjegjësisht ofertës,
- Vendin dhe kohën e mbajtjes së ankandit publik, gjegjësisht hapjes së ofertave,
- Njoftimin që paraqitësit jo me kohë, gjegjësisht kërkesat e paplotësuara, gjegjësisht ofertat nuk do të mund të marrin pjesë në procedurën e ankandit publik, gjegjësisht grumbullimin e ofertave.

Në procedurën e grumbullimit të ofertave me shkrim në fletëparaqitje shënohet shuma e cila ofrohet për patundshmërinë lëndore.

Dispozitat e këtij Vendimi, me të cilat është rregulluar procedura e marrjes së patundshmërisë në pronë publike, gjithashtu zbatohen edhe në procedurën e tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike.

Neni 17

Procedura e shqyrtimit të ofertave të arritura do të zbatohet nëse në shpallje arrin më së paku një ofertë me kohë dhe e plotë.

Procedura e ankandit publik do të zbatohet edhe në rast se arrin më së paku një fletëparaqitje me kohe dhe e plotë në bazë të së cilës paraqitësi regjistrohet dhe shpallet blerës, nëse çmimin fillestar sipas të cilës patundshmëria tjetërsohet nga prona publike pranohet si çmim i shitblerjes, ashtu që nëse nuk pranohet çmimi i shitblerjes, humbë të drejtën në kthimin e depozitit.

Pjesëmarrësi i cili ofron shumën më të lartë të çmimit të shitblerjes nënshkruan deklaratën mbi lartësinë e çmimit të ofruar të cilën është i obliguar ta paguaj në afatin e caktuar në shpallje.

Nëse pjesëmarrësi nga paragrafi 4 i këtij neni nuk e nënshkruan kontratën dhe nuk e paguan çmimin e shitblerjes në afatin e caktuar, humbë të drejtën në kthimin e depozitit.

Kriteri themelor për zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm është lartësia e çmimit të shitblerjes.

Nëse me shpallje është paraparë vënia e depozitit në procedurën e grumbullimit të ofertave me shkrim ndërsa pjesëmarrësi i cili është i zgjedhur për ofruesin më të volitshëm nuk e nënshkruan kontratën dhe nuk e paguan çmimin e shitblerjes, në afatin e caktuar me shpallje, humbë të drejtën në kthimin e depozitit, ndërsa pjesëmarrësit tjerë të procedurës së

ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim të cilët nuk janë zgjedhur për ofruesit më të volitshëm kanë të drejtë në kthimin e depozitit në afatin e caktuar me shpallje.

Komisioni pas procedurës kontestuese të ankandit publik ose grumbullimit të ofertave me shkrim përcakton propozimin që patundshmëria t'i tjetërsohet ofruesit i cili ka ofruar kushtet më të volitshme e cila i dërgohet Këshillit komunal të komunës Preshevë.

Propozim Vendimi mbi zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm, pas procedurës së zbatuar të ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim e sjell Këshilli komunal i komunës Preshevë, në bazë të propozimit të arsyetuar të Komisionit, e cila do ti dërgohet kryetarit të Komunës Preshevë.

Aktvendimin mbi zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm, pas procedurës së zbatuar të ankandit publik ose grumbullimit të ofertave me shkrim për tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike e bjen kryetari i Komunës Preshevë.

Aktvendimi i kryetarit të Komunës Preshevë është përfundimtarë.

Personi i autorizuar për nënshkrimin e Kontratës mbi tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike është kryetari i Komunës Preshevë.

3.3. Tjetërsimi i patundshmërisë nga prona publike nën çmimin e tregut, gjegjësisht pa kompenzim

Neni 18

Në veçanti Kuvendi i komunës Preshevë mundet në propozim të Këshillit komunal të sjell Vendim mbi tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike dhe nën çmimin e tregut gjegjësisht pa kompensim, nëse ekziston interesi me disponim të tillë si që janë:

1. Mënjanimi i pasojave të dëmeve elementare,
2. Vënia e marrëdhënieve të mira me shtetet tjera gjegjësisht, organizatat ndërkombëtare,
3. Dhe në raste tjera të tjetërsimit të patundshmërisë të parapara me Ligj të posaçëm.

Propozim vendimi mbi tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike nën vlerën e tregut, gjegjësisht pa kompensim, duhet të përmbajë arsyetimin prej ku mund të caktohet ekzistimi i arsyes nga al.1 i këtij neni.

Në rast të bartjes së të drejtave të pronës publike të patundshmërisë në mes të bartësve të ndryshëm të asaj të drejte, patundshmëritë mund të barten nën çmimin e tregut gjegjësisht pa kompensim, ashtu që ai disponim duhet të jetë në mënyrë të veçantë i arsyetuar.

Procedura e tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike nën çmimin e tregut, gjegjësisht pa kompensim e zbaton komisioni e cila gjatë procedurës e udhëheq procesverbalin dhe pas procedurës

kontestuese përcakton propozimin për tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike nën çmimin e tregut gjegjësisht pa kompensim, i cili i dërgohet Këshillit komunal të komunës Preshevë.

Propozim vendimi mbi tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike nën çmimin e tregut gjegjësisht pa kompensim, pas zbatimit të procedurës së patundshmërisë nga prona publike nën çmimin e tregut, gjegjësisht pa kompensim e sjell Këshilli komunal i komunës Preshevë, në bazë të propozimit të arsyetuar të Komisionit, e cila i dërgohet kryetarit të Komunës Preshevë.

Aktvendimin mbi tjetërsimin e patundshmërisë nga prona publike nën çmimin e tregut gjegjësisht pa kompenzim, pas zbatimit të procedurës së tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike nën çmimin e tregut gjegjësisht pa kompenzim e bjen kryetari i Komunës Preshevë.

Aktvendimi i kryetarit të Komunës Preshevë është përfundimtarë.

Personi i autorizuar për nënshkrimin e kontratës mbi tjetërsimin e patundshmërisë në pronën publike nën çmimin e tregut, gjegjësisht pa kompenzim është kryetari i Komunës Preshevë.

3.4. Procedura e marrjes së patundshmërisë në pronë publike dhe tjetërsimi i patundshmërisë nga prona publike me marrëveshjen e drejt për drejtë.

Neni 19

Kuvendi i komunës Preshevë në propozim të Këshillit komunal të komunës Preshevë mund të nxjerr Vendim me të cilën patundshmëritë mundet të merren në pronë publike me marrëveshjen e drejt për drejtë, por jo mbi, nga ana e organit kompetent (Administrata tatimore), vlerësimi i vlerës së tregut të patundshmërisë, nëse në rastin konkret atë e paraqet Aktvendimi i vetëm i mundshëm, me të cilën nënkuptohet:

1. Rasti kur patundshmëria e cila merret në pronë publike sipas karakteristikave e vetmja i përgjigjet nevojave të pronarit, shfrytëzuesit gjegjësisht bartësit të drejtave të shfrytëzimit, me të që propozim vendimi lidhur me këtë disponim përmban arsyetimin e shkaqeve të arsyetuara dhe tërësinë e marrjes nga aspekti i realizimit të interesit të komunës Preshevë dhe arsyet për të cilat merret nuk do të mund t'i realizon me ankand publike, gjegjësisht me grumbullimin e ofertave me shkrim,
2. Rasti kur është fjala për disponimin në mes veti në mes të bartësve të të drejtave të pronës publike,
3. Rasti i marrjes së patundshmërisë në pronë publike me anë të këmbimit nëse ky këmbim është në interes të komunës së Preshevës, me plotësimin e të gjitha kushteve nga neni 3 i Ligjit mbi pronën publike.

Neni 20

Kuvendi i komunës Preshevë në propozim të Këshillit komunal të komunës Preshevë mund të sjell Vendim me të cilin patundshmërinë në pronë publike mund të tjetërsohen nga prona publike me marrëveshjen e drejt për drejtë, por jo nën nga ana e organit kompetent (Administratës tatimore) vlerësimit të vlerës së tregut të patundshmërisë, nëse në rastin konkret atë e paraqet zgjidhja e vetme e mundshme, me arsyetimin e veçantë të arsyes së arsyeshme dhe të tërësishme të tjetërsimit dhe arsyes për të cilat tjetërsimi nuk mund të realizohet me ankand publike, gjegjësisht me grumbullimin e ofertave me shkrim.

Neni 21

Pasi që Kuvendi i komunës Preshevë të sjell Vendim që patundshmëria të jepet në pronë publike gjegjësisht të tjetërsohet nga prona publike me marrëveshje të drejt për drejtë, Këshilli komunal i komunës Preshevë formon komisionin për zbatimin e procedurës për marrjen gjegjësisht tjetërsimin e patundshmërisë me marrëveshjen e drejt për drejtë, e cila pas procedurës kontestuese të marrëveshjes së drejt për drejtë, procesverbali me propozim përkatës i dërgohet Këshillit komunal të komunës Preshevë.

Propozim Vendimin mbi marrjen e patundshmërisë gjegjësisht tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike, pas zbatimit të procedurës të marrëveshjes së drejt për drejtë e sjell Këshilli komunal i komunës Preshevë në propozimin e arsyetuar të Komisionit e cila i dërgohet kryetarit të Komunës.

Aktvendimin mbi marrjen e patundshmërisë, gjegjësisht tjetërsimit të patundshmërisë nga prona publike, pas procedurës së zbatuar të marrëveshjes së drejt për drejtë e sjell kryetari i Komunës.

Aktvendimi i kryetarit të Komunës është përfundimtar.

Personi i autorizuar për nënshkrimin e kontratës për marrjen gjegjësisht tjetërsimin e patundshmërisë me marrëveshje të drejt për drejtë është kryetari i Komunës.

Neni 22

Pagesa e çmimit të shitblerjes mund të bëhet e njëhershme ose në këste.

Nëse pagesa bëhet në këste shuma e çmimit të shitblerjes paguhet në këste të njëjta mujore, më së shumti deri 24 këste mujore.

Kur personit të cilit me kontratë mbi shitblerjen është paraparë pagesa e çmimit të shitblerjes në këste mujore, vendos që gjatë periudhës të bëjë pagesën mbi patundshmërinë e cila është lëndë e kontratës, të përmirëson, rekonstruon ose kryen punë të tjera për të cilat është e obligueshme dhënia e lejes së ndërtimit,

Është i obliguar që para dhënies së lejes së ndërtimit t'i shlyen këstet e mbetura në një shumë të njëhershme të përcaktuar me Kontratë.

Blerësi mundet edhe para afatit të caktuar me kontratë të bëjë pagesën e borxhit të mbetur.

Neni 23

Pas nënshkrimit të kontratës mbi shitblerjen dhe grumbullimin e dëshmimeve mbi rregullimin e obligimeve në mes veti me komunën e Preshevës, për të cilën Administrata komunale e komunës Preshevë-drejtoriati kompetent për punët financiare jep vërtetimin, arrihen kushtet për regjistrimin e të drejtës së pasurisë në regjistrin publik mbi patundshmëri dhe të drejtat lëndore në to.

Kur me kontratën mbi shitblerjen është paraparë pagesa në këste mujore Administrata komunale e komunës Preshevë ia dërgon kopjen e Kontratës së shitblerjes shërbimit për kadastër të patundshmërisë Preshevë me qëllim të regjistrimit të para shënimit mbi pagesën e çmimit të shitblerjes në këste mujore.

3.5. Marrja e patundshmërisë në pronë publike me marrëveshjen e drejt për drejtë me anë të këmbimit të patundshmërisë me investitorin e ndërtimit të objektit kur komuna e Preshevës është bartëse e të drejtës së pronës publike në objekt

Neni 24

Komuna e Preshevës mund të merr patundshmërinë me anë të këmbimit në pronë publike me investitorin e ndërtimit të objektit kur Komuna e Preshevës është bartëse e të drejtës së pronës publike në ndërtesa, gjegjësisht në pjesët e saja të posaçme, të cilat janë të parapara për rrënim, me qëllim të udhëheqjes së lokacionit dedikimit të planifikuar, përcaktohen kriteret në vijim për realizimin e këmbimit të patundshmërisë në pronë publike me marrëveshje të drejt për drejtë:

- Komuna e Preshevës në emër të kompensimit për patundshmërinë e cila jepet në këmbim duhet ti takoj patundshmëria e cila ka sipërfaqe më të madhe më së paku 15% kur komuna është pronar i pakicës në objekt i cili është i paraparë për rrënim gjegjësisht në rast se komuna është pronar në shumicë më së paku 50% në lidhje me sipërfaqen e patundshmërisë në pronë publike e cila jepet në emër të këmbimit, ashtu që në çdo rast oferta e investitorit nuk mund të jetë më e vogël nga mesatarja e realizuar e arritur në këmbim të patundshmërisë me pronarët tjerë të pjesëve të etazhit të patundshmërisë në lokacionin lëndorë e në bazë të kontratave të nënshkruara mbi rregullimin e marrëdhënieve pronësoro- juridike në mes të personave të cekur,
- Nëse komuna e Preshevës në procedurën e këmbimit të patundshmërisë ofron të se patundshme ekzistuese në lokacion tjetër në pronësi të investitorit të ndërtimit, pranë kriterëve nga paragrafi 1 i këtij neni është e

duhur që ajo patundshmëri të jetë në zonën e njëjtë afariste, gjegjësisht banesore dhe sipas pozitës, strukturës, lokacionit dhe dedikimit të saj ti përgjigjet patundshmërisë ekzistuese në pronën publike me të cilën këmbëhet, gjithashtu që kjo patundshmëri të jetë e regjistruar në librat përkatëse publike mbi evidentimin e patundshmërisë dhe të drejtave në to si pronë e investitorit.

Me kontratën mbi këmbimin e patundshmërisë duhet të jetë paraparë edhe dënimi kontraktues për rast të vonesës së investitorit potencial të ndërtimit të objektit banesorë gjegjësisht afarist në lokacionin e cila vihet në dedikim të planifikuar, sipas afatit për ndërtimin dhe dorëzimin në posedim të patundshmërisë të posa ndërtuar e cila i jepet komunës në emër të këmbimit të patundshmërisë në pronë publike.

Me kontratën mbi këmbimin e patundshmërisë duhet të përcaktohet formimi i hipotekës mbi patundshmërinë e caktuar në pronë të investitorit të ndërtimit ose personit të tretë me të cilën sigurohet ekzekutimi i obligimeve të veta, kur investitori është person fizik gjegjësisht ndërmarrës kur investitori i ndërtimit është subjekt ekonomik (ndërmarrje gjegjësisht shoqëri ekonomike) është e duhur nga investitori të sigurohet vendosja e hipotekës ose origjinalen, pa kushte, të parevokueshme dhe të paguar në ftesën e parë të garancionit bankar të bankës së klasit të parë në lartësi të vlerës së vlerësuar së patundshmërisë të sapa ndërtuar të cilën komuna e merr me këmbim.

Pasi që Kuvendi i komunës Preshevë sjell vendimin mbi marrjen e patundshmërisë në pronë publike me marrëveshje të drejt për drejtë me anë të këmbimit të patundshmërisë me investitorin e ndërtimit të objektit kur komuna është bartëse e të drejtave të pronës publike në objekt, Këshilli komuna i komunës Preshevë formon Komisionin për zbatimin e procedurës së marrjes së patundshmërisë në pronë publike me marrëveshje drejt për drejtë me anë të këmbimit të patundshmërisë me investitorin e ndërtimit të objekteve kur komuna është bartëse e të drejtës së pronës publike në objekt, e cila pas procedurës kontestuese, procesverbali me propozimin përkatës i dërgon Këshillit komunal të komunës Preshevë.

Propozim vendimin e marrjes së patundshmërisë në pronë publike me marrëveshje të drejt për drejtë me anë të këmbimit të patundshmërisë me investitorin e ndërtimit të objekteve kur komuna është bartëse e të drejtës së pronës publike në objekt, pas procedurës së zbatuar, sjell Këshilli komunal i komunës në propozimin e arsyetuar të Komisionit, e cila i dërgohet kryetarit të Komunës Preshevë.

Aktvendimin mbi marrjen e patundshmërisë në pronë publike me marrëveshje të drejt për drejtë me anë të këmbimit të patundshmërisë me investitorin

e ndërtimit të objekteve kur Komuna është bartëse e të drejtës së pronës publike në objekt pas procedurës së zbatuar e sjell kryetari i Komunës.

Aktvendimi i kryetarit të Komunës Preshevë është përfundimtarë.

Personi i autorizuar për nënshkrimin e Kontratës mbi marrjen e patundshmërisë në pronë publike me marrëveshje të drejt për drejtë me anë të këmbimit të patundshmërisë me investitorin e ndërtimit të objekteve kur komuna është bartëse e të drejtës së pronës publike në objekt është kryetari i Komunës.

3.6. Marrja dhe tjetërsimi i sendeve të luajtshme në pronë publike

Neni 25

Këshilli komunal i komunës Preshevë sjell Vendimin mbi marrjen në pronë publike të sendeve të luajtshme për nevojat e komunës.

Sendet e luajtshme merren sipas nevojave, por në pëlqim të dispozitave të Ligjit mbi prokurimet publike, ligjit mbi pronën publike dhe aktet nënligjore.

Vendimin mbi tjetërsimin e sendeve të luajtshme nga prona publike e sjell Kuvendi i komunës, ndërsa procedura kryhet sipas rregullës, me anë të shpalljes publike gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim, në mënyrë me të cilën sigurohet interesi i bartësit të të drejtave të pronës publike dhe në procedurë që aplikohet për tjetërsimin e sendeve të paluajtshme, përveç për tjetërsimin e sendeve të luajtshme me vlerë të vogël, kur Vendimin mbi tjetërsimin e sjell Këshilli komunal i komunës Preshevë, në propozim të komisionit për tjetërsimin e sendeve të luajtshme, të cilën e emëron kryetari i Komunës.

Vlerësimin e sendeve të luajtshme të cilat tjetërsohen nga prona e komunës së Preshevës e caktojnë institucionet, organizatat kompetente ose personat profesional të cilët janë të specializuar për lëmin e caktuar.

Në veçanti nga al.3 i këtij neni tjetërsimi i sendeve të luajtshme mund të bëhet me marrëveshje të drejt për drejtë.

Tjetërsimi i sendeve të luajtshme nga prona publike mund të bëhet edhe nën çmimin e tregut gjegjësisht pa kompenzim, nëse ekziston interesi me disponim të tillë, si që është mënjanimi i pasojave të dëmeve elementare edhe në rastet tjera të përcaktuara me Ligj dhe aktet nënligjore.

Vendimi mbi tjetërsimin e sendeve të luajtshme nga prona publike duhet të përmbajë arsyetimin nga e cila mund të përcaktohet ekzistimi i arsyes nga paragrafi 6 i këtij neni.

Rastet dhe kushtet nën të cilat mund të kryhet tjetërsimi i sendeve të luajtshme nga prona publike me marrëveshje të drejt për drejtë dhe rastet tjera nga paragrafi 6 i këtij neni përcaktohen me Ligjin dhe aktet nën ligjore.

Sendet e luajtshme në pronën publike të vlerës më të vogël sipas këtij Vendimi paraqesin sendet vlera e tregut të të cilave nuk e kalon shumën prej 500 Euro në kundërvlerë të dinarit sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Serbisë në ditën e tjetërsimit.

IV. DHËNIA ME QERA E SENDEVE TË PALUAJTSHME DHE SENDEVE TË LUAJTSHME NË PRONË PUBLIKE TË KOMUNËS

4.1. Dhënia me qera e patundshmërisë me ankand publik ose grumbullimin e ofertave me shkrim

Neni 26

Sendet e të paluajtshme në pronë publike të komunës mund të jepet me qera.

Sipas rregullës sendet e të paluajtshme nga paragrafi 1 i këtij neni jepet me qera në procedurë të ankandit publik ose grumbullimit të ofertave me shkrim.

Veçmas nga paragrafi 2 i këtij neni dhënia me qera e sendeve të paluajtshme mund të bëhet edhe me marrëveshje të drejt për drejtë.

Sendet e paluajtshme në pronë publike të komunës jepen me qera në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Urdhëresë.

Neni 27.

Mbi dhënien me qera të sendeve të paluajtshme në pronë publike të komunës, në propozim të Këshillit komunal të komunës Preshevë, Vendimin e sjell Kuvendi i komunës Preshevë në pajtim me Ligjin, Urdhëresën dhe këtë Vendim.

Vendimi mbi dhënien me qera të patundshmërisë në pronë publike përmban:

- Emërtimin e organit dhe shfrytëzuesit e patundshmërisë e cila jepet me qera në pronë publike (emërtimi i qiradhënësit),
- Shënimet më të afërta mbi mënyrën e dhënies me qera të patundshmërisë në pronë publike (ankandi publik ose grumbullimi i ofertave me shkrim),
- Përshkrimi i patundshmërisë në pronë publike e cila jepet me qera,
- Kushtet me të cilat patundshmëria në pronë publike jepet me qera (afati i zgjatjes së qeras etj.),
- Obligimet e qiramarrësit lidhur me shfrytëzimin e patundshmërisë për qëllimin dhe dedikimin e caktuar,
- Koha dhe vendi i mbajtjes së ankandit publik, gjegjësisht shqyrtimi i ofertave të arritura,
- Mënyra, vendi dhe koha për dërgimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në procedurën e ankandit publik gjegjësisht ofertave me shkrim për pjesëmarrje në procedurën e grumbullimit të ofertave me shkrim,

- Vendi dhe koha e qasjes në dokumentacionin lidhur me patundshmërinë e cila jepet me qera,
- Lartësinë fillestare, gjegjësisht lartësinë më të ulët të qirasë nën të cilën patundshmëria në pronë publike mund të jepet me qera,
- Lartësinë dhe mënyrën e vënies së depozitit,
- Afatin për kthimin e depozitit të pjesëmarrësve të cilët nuk kanë arritur në ankandin publik, gjegjësisht në procedurën e grumbullimit të ofertës me shkrim.

Neni 28.

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit të komunës Preshevë, Këshilli komunal i komunës formon komisionin për zbatimin e procedurës së dhënies me qera të patundshmërisë në pronë publike të komunës.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni ka kryetarin, zëvendësin dhe tre anëtarë.

Pas nxjerrjes së akteve mbi iniciimin e procedurës së dhënies me qera të patundshmërisë në pronë publike, Komisioni shpallë shpalljen mbi zbatimin e procedurës së ankandit publik ose grumbullimin e ofertave me shkrim që përmban:

- Emërtimin e organit dhe shfrytëzuesit e patundshmërisë e cila jepet me qera në pronë publike (emërtimi i qiradhënësit),
- Shënimet më të afërta mbi mënyrën e dhënies me qera të patundshmërisë në pronë publike (ankandi publik ose grumbullimi i ofertave me shkrim),
- Përshkrimi i patundshmërisë në pronë publike e cila jepet me qera,
- Kushtet me të cilat patundshmëria në pronë publike jepet me qera (afati i zgjatjes së qeras etj.),
- Obligimet e qiramarrësit lidhur me shfrytëzimin e patundshmërisë për qëllimin dhe dedikimin e caktuar,
- Koha dhe vendi i mbajtjes së ankandit publik, gjegjësisht shqyrtimi i ofertave të arritura,
- Mënyra, vendi dhe koha për dërgimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në procedurën e ankandit publik gjegjësisht ofertave me shkrim për pjesëmarrje në procedurën e grumbullimit të ofertave me shkrim,
- Vendi dhe koha e qasjes në dokumentacionin lidhur me patundshmërinë e cila jepet me qera,
- Lartësinë fillestare, gjegjësisht lartësinë më të ulët të qirasë nën të cilën patundshmëria në pronë publike mund të jepet me qera,
- Lartësinë dhe mënyrën e vënies së depozitit,
- Afatin për kthimin e depozitit të pjesëmarrësve të cilët nuk kanë arritur në ankandin publik, gjegjësisht në procedurën e grumbullimit të ofertës me shkrim.

Shpallja mbi zbatimin e procedurës së ankandit publik ose grumbullimit të ofertave me shkrim për dhënien me qera të patundshmërisë në pronën publike shpallet në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve të komunës dhe në faqen zyrtare të internetit të komunës Preshevë.

Detyra e komisionit është të zbaton procedurën sipas shpalljes për grumbullimin e ofertave me shkrim, gjegjësisht sipas shpalljes për ankand publike të cakton ofertën më të volitshme me shkrim, gjegjësisht personin i cili ofron të paguaj shumën më të madhe të qerasë.

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjes për ankand publike, gjegjësisht grumbullimi i ofertave me shkrim nuk mund të jetë më i shkurtër prej tetë e as më i gjatë se 30 ditë nga dita e shpalljes në shpallje.

Neni 29

Pjesëmarrësi në shpallje me depozit garanton se do të nënshkruaj kontratën mbi qiranë, nëse oferta e tij në procedurë sipas shpalljes të caktohet si më e volitshme.

Depoziti paguhet në llogari të posaçme të komunës, me rastin e dorëzimit të fletëparaqitjes për ankand publike gjegjësisht paraqitjen e ofertave me shkrim.

Neni 30

Përmbajtja e fletëparaqitjes, gjegjësisht e ofertës është e paraparë me Urdhëresë.

Në procedurën e ankandit publik, gjegjësisht grumbullimin e ofertave me shkrim udhëhiqet procesverbali.

Fletëparaqitjet për ankand publike, gjegjësisht ofertat e shkruara i dërgohen Komisionit në koverta të mbyllura, me shenjë “të mos hapet- oferta në shpallje”, gjegjësisht “të mos hapet- fletëparaqitja për ankand publike për dhënien me qera të lokalit afarist”, nëpërmes shkresores së Komunës së Preshevës.

Në mbështjellësin e ofertave të arritura, gjegjësisht fletëparaqitjeve, shënohet data e dorëzimit, ndërsa pjesëmarrësve të shpalljes i jepet dëshmia për dorëzimin e ofertës, gjegjësisht fletëparaqitjes.

Neni 31

Pas skadimit të afatit për grumbullimin e ofertave me shkrim, gjegjësisht për dërgimin e fletëparaqitjeve për ankand publike, nuk mund të dërgohen oferta dhe fletëparaqitje të reja, e as të ndryshohen dhe plotësohen ofertat e dërguara në afat. Ofertat, gjegjësisht fletëparaqitjet të cilat janë dërguar pas afatit të caktuar, anulohen pas afatit.

Neni 32

Komisioni që zbaton procedurën sipas shpalljes për grumbullimin e ofertave me shkrim, gjegjësisht ankandit publike takohet në kohë dhe ditën

e caktuar me shpallje për hapjen e ofertave me shkrim, gjegjësisht për mbajtjen e ankandit publik.

Komisioni vërteton sa oferta dhe fletëparaqitje janë dorëzuar, se a janë dorëzuar me afat, cilët janë pjesëmarrësit e shpalljes, gjegjësisht të autorizuarit e tyre prezent në hapjen e ofertave, gjegjësisht ankandit publik./

Kriteri sipas të cilit në procedurën e dhënies me qera zgjedhet ofertuesi më i volitshëm, është kriteri i ofertës më të lartë të qerasë.

Neni 33

Njoftimi për rezultatet e shpalljes publikohen në web.sajtin e komunës Preshevë dhe në tabelën e shpalljeve të komunës Preshevë.

Neni 34

Pas kontestimit të procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim, kontrata mbi qeranë e lokalit afarist nënshkruhet me pjesëmarrësin e shpalljes me vërtetimin e ofertës më të volitshme me shkrim, gjegjësisht me pjesëmarrësin e ankandit publik i cili ka ofruar të paguaj shumën më të madhe të qerasë.

Propozim vendimin mbi dhënien me qera të patundshmërisë në pronën publike, e sjell Këshilli komunal i Komunës në propozim të arsyetuar të Komisionit e cila i dërgohet kryetarit të Komunës Preshevë.

Aktvendimin mbi dhënien me qera të patundshmërisë në pronë publike, e sjell kryetari i Komunës.

Aktvendimi i kryetarit të komunës Preshevë është përfundimtarë.

Personi i autorizuar për nënshkrimin e kontratës mbi dhënien në qera të patundshmërisë në pronë publike është kryetari i Komunës Preshevë.

Nëse pjesëmarrësi i shpalljes nga paragrafi 1 i këtij neni heq dorë nga nënshkrimi i kontratës mbi qeranë e lokalit afarist, shpallet shpallja e re për grumbullimin e ofertave me shkrim, gjegjësisht për ankand publike.

Neni 35

Pjesëmarrësit e shpalljes për grumbullimin e ofertave me shkrim, gjegjësisht për ankand publike kanë të drejtë në kthimin e depozitit të dhënë në afat prej 8 ditësh nga dita e zbatimit të procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim, pa llogaritjen e kamatës, me zvogëlim prej 5% në emër të shpenzimeve për zbatimin e procedurës sipas shpalljes.

Pjesëmarrësi i shpalljes me vërtetimin e ofruesit më të volitshëm ka të drejtë në kthimin e depozitit të dhënë në afat prej 3 ditësh nga dita e nënshkrimit të Kontratës mbi qeranë, pa llogaritjen e kamatës, të zvogëluar për 5% në emër të shpenzimeve të zbatimit të procedurës sipas shpalljes.

Nëse pjesëmarrësi i shpalljes me vërtetimin e ofruesit më të volitshëm heq dorë nga nënshkrimi i kontratës mbi qeranë, nuk ka të drejtë në kthimin e depozitit të dhënë.

4.2. Dhënia me qera e sendeve të paluajtshme në pronë publike të komunës jashtë procedurës së ankandit publik gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim

Neni 36

Patundshmëritë në pronën publike mundën në veçanti të jepen me qera edhe jashtë procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim në rastet:

- Kur me qera kërkojnë Ambasadat e shteteve të jashtme në Republikën e Serbisë, si dhe përfaqësitë tregtare dhe ushtarake dhe organizatat tjera pranë përfaqësive diplomatike- konzulare në Republikën e Serbisë, me kusht të reciprocitetit, organizatat ndërkombëtare për ndihmë dhe bashkëpunim me vendet e Unionit europian, organizatat humanitare ndërkombëtare me qëllim të sigurimit të kushteve për vendosje dhe punë në Republikën e Serbisë, si dhe organizatat vendore humanitare, partitë politike, organizatat dhe shoqatat e qytetarë nga lëmi i shëndetësisë, kulturës, shkencës, arsimit, sportit mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve, me kusht që ajo hapësirë të mos shfrytëzohet për realizimin e të hyrave,
- Kur qiramarrësi pushon të kryej veprimtarinë e vetë, për arsye të sëmundjes së rëndë, shkuarjes në pension ose vdekjes, ndërsa dhënien me qera e kërkon bashkëshorti-ja, fëmija ose prindi i qiramarrësit (anëtarët e amvisërisë familjare), me kusht të vazhdon me kryerjen e veprimtarisë së njëjtë,
- Kur qiramarrësi- personi juridik kërkon caktimin për qiramarrësin personi tjetër juridik që është themelues ose kur qiramarrësi- personi juridik kërkon caktimin për qera të personit tjetër juridik, që të dy personat juridik kanë themeluesin e njëjtë, gjegjësisht kur te qiramarrësi- personi juridik ka ardhur deri te ndryshimi i caktuar i statusit,
- Kur qiramarrësi- personi fizik kërkon caktimin për qera personi juridik themelues i të cilit ose kur themeluesi i personit juridik, për arsye të shlyerjes së të njëjtës nga regjistri i organit kompetent kërkon të jetë i caktuar për qiramarrës, si person fizik,
- Kur qiramarrësi i cili me rregull ka kryer obligimet e pagesës së qerasë, kërkon vazhdimin e kontratës mbi qeranë të kontraktuar në kohë të caktuar, më së paku tre muaj, e më së voni një muaj para kalimit të kontratës mbi qeranë,

- Kur patundshmëria jepet për mbajtjen e nevojave sportive, kulturore, panairove dhe nevojave shkencore dhe të tjera, ndërsa afati i qerasë është më i shkurtër se 30 ditë,
- Kur patundshmëria nuk jepet me qera pas zbatimit të njëres procedurë të shpalljes publike, por jo nën shumën e lartësisë së qerasë së tregut për këtë patundshmëri, gjegjësisht lartësinë e qerasë së paraparë me aktin e përgjithshëm të organit kompetent,
- Kur dhënien me qera e kërkon personi fizik të cilit kjo patundshmëri i është marrë me nacionalizim, gjegjësisht të pasardhësve të tij me kusht se është iniciuar procedura për kthimin e pasurisë së marrë pranë organit kompetent,
- Kur njëri nga qiramarrësit e patundshmërisë së njëjtë kërkon ndërprerjen e raportit qiramarrës, ndërsa qiramarrësi tjetër kërkon kontraktimin e kontratës mbi qeranë, si qiramarrës i vetëm,
- Kur qiramarrësi- personi juridik kërkon caktimin për qera të patundshmërisë personi tjetër juridik, me kusht që ai të kryen tërë borxhin e qerasë të shkaktuar për arsye të mospagesës së qerasë dhe shpenzimeve të shfrytëzimit të patundshmërisë me qera, e nëse ky borxh është i pamundur të shlyhet në mënyrë tjetër,
- Kur kjo është e nevojshme për arsye të organizimit më të mirë dhe punës më efikase të bartësit të së drejtës në pronë publike, gjegjësisht shfrytëzuesit të gjërave në pronë publike, si dhe sipas shërbimeve dhe organizatave të veçanta themelues i të cilëve janë ata,
- Kur kontraktimin e kontraktuar mbi qeranë e garazhës e kërkon pronari i banesës ose qiramarrësi i banesës ku garazha është pjesë përbërse e banesës dhe me banesën e përbënë një tërësi, gjegjësisht ka komunikim vertikal me banesën.

Pasi që Kuvendi i komunës Preshevë bjen Vendimin mbi dhënien me qera jashtë procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim, Këshilli komunal i komunës formon komisionin për zbatimin e procedurës mbi dhënien me qera jashtë procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim, e cila pas procedurës kontestuese, procesverbali me propozimin përkatës i dërgohet Këshillit komunal të komunës Preshevë.

Propozim Vendimi mbi dhënien me qera jashtë procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim pas procedurës së zbatuar e sjell Këshilli komunal i komunës Preshevë në propozim të arsyetuar të Komisionit e cila i dërgohet Kryetarit të komunës.

Aktvendimin mbi dhënien me qera jashtë procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim pas zbatimit të procedurës, e sjell kryetari i Komunës.

Aktvendimi i kryetarit të komunës Preshevë është përfundimtarë.

Personi i autorizuar për kontraktimin e kontratës mbi dhënien me qera jashtë procedurës së ankandit publik, gjegjësisht grumbullimit të ofertave me shkrim është kryetari i Komunës.

4.3. Dhënia me qera e sendeve të luajtshme në pronën publike të komunës

Neni 37

Në rastin e dhënies me qera të sendeve të luajtshme në pronën publike të komunës gjithashtu implementohen dispozitat të cilat rregullojnë dhënien me qera të gjërave të patundshme në pronën publike të komunës.

Sendet e luajtshme në pronën publike mund të jepen me qera, duke u nisur nga lartësia e qerasë në treg të cilën e përcakton organi kompetent tatimorë.

4.4. Kontraktimi i kontratës mbi qeranë, të drejtat dhe obligimet e palëve të kontraktuar dhe ndërprerja e Kontratës

Neni 38

Personave të cilëve gjërat në pronë publike të komunës jepen me qera janë të obliguar të nënshkruajnë kontratën mbi qeranë në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit përfundimtarë.

Kontrata mbi qeranë e gjërave në pronë publike të komunës përmban:

1. Palët kontraktuese,
2. Data dhe vendi i nënshkrimit,
3. Shënimet mbi gjërat,
4. Periudha për të cilën kontrata nënshkruhet,
5. Shuma e qerasë,
6. Afati dhe mënyra e pagesës së qerasë,
7. Të drejtat dhe obligimet e palës kontraktuese,
8. Veprimtaria të cilën qiramarrësi do ta kryej në lokalet afariste,
9. Dispozitën që qiramarrësi mund ta ndryshon veprimtarinë për kohë të zgjatjes së qerasë, me pëlqim të Administratës komunale,
10. Dispozitën mbi mjetet e sigurimit të pagesës të qerasë së ardhshme, shpenzimeve komunale dhe shpenzimeve tjera të cilat dalin nga shfrytëzimi i lokalit afarist (hipoteka në të patundshmen, aksionet në sendet e luajtshme, garancioni i parevokueshëm bankar, siguria e personit tjetër që është pronar i pronës vlera e të cilës nuk duhet të jetë më e vogël se 150% e lartësisë së hulumtimit që sigurohet kambiali i akceptuar nga ana e dy zhirantëve nga fitimi i të cilëve vendoset ndalesa administrative borxhin mund ta paguaj, kambiali i vërtetuar nga ana e bankës afariste,

kambiali i posaçëm dhe mjetet tjera që mund të shërbejnë për sigurimin e pagesës), sipas zgjedhjes së Administratës komunale në lartësi gjashtë qirave mujore për lokalin afarist,

11. Dispozitën mbi ndryshimin e lartësisë së qerasë në pajtim me Ligjin,
12. Dispozitat mbi ndërprerjen e kontratës,
13. Nënshkrimet e palëve të kontraktuara dhe
14. Shënimet tjera të nevojshme.

Neni 39

Kontratat mbi qeranë e gjërave në pronë publike të komunës kontraktohen në kohë të caktuar në pajtim me këtë Vendim, në periudhën që nuk mund të jetë më e gjatë se 5 (pesë) vite.

Neni 40

Qiraja paguhet deri në 15 e muajit për muajin vijues.

Nëse në procedurën e dhënies së patundshmërisë në pronë publike të komunës me qera me ankand publike, grumbullimin e ofertave me shkrim dhe marrëveshjen e drejt për drejtë është përcaktuar pagesa e qerasë më parë për periudhën e caktuar ose mënyrën tjetër të pagesës, qiraja paguhet në pajtim me këto kushte.

Qeraja e përcaktuar me kontratën mbi qeranë është në shumën bruto, me tatimin e llogaritur në vlerën shtesë dhe harmonizohen në muaj për lartësinë e indeksit të çmimit harxhues, sipas shënimeve të organit republikan kompetent për punët statistikore.

Neni 41

Personit të cilit sendet e paluajtshme në pronë publike të komunës Preshevë i janë dhënë me qera, është i obliguar që:

1. Të shfrytëzon sendet e paluajtshme, në rast se me Kontratë është paraparë dedikimi, sendet e paluajtshme shfrytëzohen në pajtim me dedikimin,
2. Nuk i jep sendet e paluajtshme në nën qera, e as në ndonjë mënyrë tjetër të disponimit me sendet e paluajtshme,
3. Në kohë të caktuar paguan qeranë ,
4. Bartë shpenzimet e mirëmbajtjes vijuese, intervenimet urgjente, shfrytëzimi i sipërfaqeve të përbashkëta dhe shërbimeve komunale,
5. Ruan dhe mirëmban pajisjet, aparatet dhe pajisjet tjera me të cilat sendet e paluajtshme janë të dhëna me qera,
6. Mundëson dhe nuk pengon mirëmbajtjen investicionale, nëse është e duhur të bëhet,
7. Kryen rekonstruimin ose sanimin e sendeve të paluajtshme, nëse ajo është e caktuar si kusht i dhënies me qera,
8. I dorëzon sendet e paluajtshme pas skadimit të qerasë,

9. Kompenzon çdo dëm në sendet e paluajtshme dhe pajisjet që i janë dhënë me qera.

Nëse personi sendet e të paluajtshme të cilat janë dhënë me qera, i jep në nën qera ose në mënyrë tjetër dhe me të njejtat disponon, humb të drejtën e qerasë, e nëse ate e bënë personi të cilit sendet e paluajtshme i janë dhënë me qera, me marrëveshjen e drejt për drejtë, në të ardhmen humbë të drejtën e ndarjes së sendeve të paluajtshme në shfrytëzim dhe të drejtën e dhënies me qera me marrëveshje të drejt për drejtë.

Neni 42

Kontrata mbi qeranë e sendeve të paluajtshme në pronë publike të komunës ndërprehet në pajtim me Ligjin mbi marrëdhëniet obligative.

Neni 43

Palët kontraktuese mund të ndërprejnë kontratën nëse për arsytet të rrethanave të ndryshueshme, të cilat nuk janë paraparë në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës.

Neni 44

Komuna e Preshevës mund të heq dorë nga kontrata për arsytet si vijojnë:

1. Nëse sendet e patundshme nuk shfrytëzohen ose nuk shfrytëzohen në pajtim me dedikimin, nëse ajo është e paraparë me Kontratë,
2. Nëse sendet e patundshme jepen nën qera,
3. Nëse sendet e patundshme nuk mirëmbahen në pajtim me kontratën, gjegjësisht nuk mundëson mirëmbajtjen investicionale,
4. Nëse nuk kryhet sanimi kontraktues, gjegjësisht rekonstruimi ose nëse e njehta kryhet pa pëlqimin e duhur,
5. Nëse qera marrësi nuk e paguan qeranë as në afatin prej 15 ditësh nga dita kur Komuna e ka ftuar të bëjë pagesën,
6. Nëse qera marrësi dy muaj pa ndërprerë nuk i kryen obligimet në bazë të qerasë,
7. Nëse qiramarrësi në afatet e arritura nuk paguan shpenzimet komunale, gjegjësisht çdo tre muaj nuk dërgon dëshmi mbi shpenzimet e paguara komunale,
8. Nëse sendet e patundshme i nevojiten komunës për dedikime tjera.

Neni 45

Qiramarrësi nuk mund të bëjë adaptimin e lokalit afarist pa pëlqimin e mëparshëm të komunës.

Komuna e Preshevës mundet sipas kërkesës së qiramarrësit të lejon kryerjen e punëve që kanë karakter të mirëmbajtjes investicionale në qiradhënie të patundshmërisë, sipas standardeve të zakonshme dhe dispozitave të vlefshme në lëmin e ndërtimtarisë.

Pëlqimin për kryerjen e punëve në mirëmbajtjen e investicionale të sendeve të

patundshme e jep komisioni për lejimin e punëve dhe pranimin e mjeteve të deponuara, të cilën e arsyeton kryetari i Komunës.

Të gjitha shpenzimet e adaptimit të qirasë së patundshmërisë janë të kryera në pajtim me paragrafi 1 të këtij neni dhe i bien në barrë qiramarrësit.

Komisioni nga paragrafi 3 i këtij neni, pas kontestimit të punëve bënë llogaritjen përfundimtare dhe vlerësimin e mjeteve të deponuara në mirëmbajtjen investicionale të gjërave të patundshme.

Raporti mbi gjendjen ekzistuese të patundshmërisë me përshkrimin, paramatjen dhe parallogarinë e punëve të planifikuara, duhet ta përpilon ekspertuesi i autorizuar gjygjësor i degës përkatëse, gjegjësisht organizata e autorizuar me të cilin qiradhënësi duhet të nënshkruaj kontratë mbi bashkëpunimin afarist, ashtu që shpenzimet e përpilimit të këtij dokumentacioni ti bartë qiramarrësi.

Qiramarrësi është i obliguar që gjatë kryerjes së punëve të lejuara nga ana e qiradhënësit, në procedurën e përshkruar në paragrafi 2 të këtij neni ti përmbahet përshkrimit të lejuar para matjes dhe parallogarisë si dhe në rastin e heqjes dorë nga punët e lejuara në mirëmbajtjen investicionale të sipërfaqes afariste në çdo rast veçmas prej qiradhënësit të kërkoj leje për heqjes dorë.

Punët në mirëmbajtjen investicionale të kryera në kundërshtim me paragrafi 3 të këtij neni si dhe punët të cilat i tejkalojnë standardet e zakonshme për atë lloj të punëve nuk do ti pranohen qiramarrësit.

Pas kryerjes së punëve me pëlqimin e qiradhënësit në mënyrën dhe procedurën e përshkruar në këtë nen, qiramarrësi është i obliguar që qiradhënësit ti paraqet kërkesë për pranimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes investicionale të sipërfaqes afariste, me të cilën si dëshmi dërgojnë llogaritë, ashtu që shuma e mjeteve të investuara duhet të jetë e verifikuar nga ana e ekspertuesit të autorizuar, gjegjësisht organizatës e cila do të vlerësoj vlerën, kualitetin dhe standardet e punëve të kryera dhe gjendjes së tërësishme të patundshmërisë, në krahasim me raportin mbi gjendjen ekzistuese, përshkrim, paramatje dhe parallogarin e punëve të planifikuara të lejuara nga ana e qiradhënësit.

